Mal Berisha

NJË NDERIM PËR FAMILJEN IVANAJ,

BIJËN E TYRE DRITA

DHE FONDACIONIN QË MBAN EMRIN E TYRE:

"IVANAJ"

Drita Ivanaj dhe Fondacioni "Martin & Mirash Ivanaj", i themeluar prej saj në rrugën "Perlat Rexhepi" në Tiranë.

Pjesa e Parë

FONDACIONI MARTIN & MIRASH IVANAJ – NJË XHEVAHIR KULTURE DHE DIJE NË MES TË TIRANËS

Hyrje

Një vegim i largët rreth emrit "Mirash"
Ishte viti 1959 kur u ula për herë të parë në bangën e klasës së parë të shkollës fillore "Asim Vokshi" në Tropojë. Ishte një shkollë e vogël, e themeluar në vitin 1923, pas dy shkollave të tjera të hapura në rrethin tonë: asaj të fshatit Gjonpepaj në vitin 1917 dhe asaj të Kolgecajt – sot B. Curri – në vitin 1922. Aty kishte mësuar germën e parë të shqipes edhe babai im.

Në ato vite fëmijërie, teksa më përcillte për në mësim – në këmbë, në një largësi prej më pak se dy kilometrash – im atë më tregonte sesi kishte qenë ajo shkollë në vitet e fëmijërisë së tij. Më fliste për mësuesit, të cilët nxënësit i adhuronin thuajse si hyjni. Pastaj më rrëfente se, kur ai kishte qenë nxënës po aty, në vitet '30, ata rreshtoheshin çdo ditë në oborr, secili pranë mësuesit përkatës. Drejtori i shkollës iu mbante një fjalim të shkurtër atdhetarie dhe, më pas, mësues e nxënës së bashku këndonin Himnin Kombëtar.

Pas këtij rituali të përditshëm, gjithmonë sipas babait, fillonte mësimi. Ai më tregonte për disiplinën e rreptë që mbizotëronte dhe, sidomos, për marrëdhëniet me mësuesit, duke më këshilluar që edhe unë t'i respektoja mësuesit e mi – të cilët ai vetë i njihte të gjithë. Shpesh gjente rastin të më tregonte se, në kohën kur ai ishte nxënës, kishte pasur një mësues shumë të zoti, i cili më vonë ishte bërë edhe ministër.

Ministri kishte vendosur rregull të madh në arsim, ndaj të gjithë e donin shumë. Ishte aq i dashur për mësuesit dhe nxënësit, saqë, kur u largua nga ajo detyrë, të gjithë u mërzitën shumë. Babai dinte se ky ministër e donte fort gjuhën shqipe dhe dëshironte që

ajo të mësohej në mënyrë të përsosur. Ai quhej Mirash, dhe unë e mbaja mend këtë emër sepse një nga fqinjët tanë kishte të njëjtin emër dhe dallohej, pasi ishte e vetmja familje e fesë katolike në fshatin tonë.

Më vonë, babai më tregoi për ditën kur thuhej se gjëmuan topat aq shumë në bregdetin e Durrësit, sa jehona e tyre u dëgjua deri tek ne, atje, midis Alpeve. Ishte ushtria italiane që pushtoi Shqipërinë. Mësuesit e shkollës, atë të Premte të Zezë të 7 prillit 1939, njoftuan të gjithë nxënësit të dilnin nga klasat dhe të rreshtoheshin para shkollës. Drejtori, me lot në sy dhe duke qarë me dënesë, u tregoi atyre se Shqipëria, prej asaj dite, nuk ishte më e pavarur.

Ajo ishte pushtuar nga italianët. Pastaj, drejtori i ftoi të gjithë të këndonin Himnin Kombëtar dhe u tha se do të vinin sërish në shkollë vetëm kur t'i thërrisnin përsëri.
"Ne fëmijët, – vazhdonte ai, – ikëm me vrap, të gjithë duke qarë, por pa e kuptuar aq mirë se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë. Edhe Mbreti kishte ikur diku larg."

Pas disa ditësh, kur na njoftuan të ktheheshim në shkollë, në vend të Himnit Kombëtar – që na ishte lënë trashëgim nga Ministri Mirash Ivanaj, tani na mësuan të këndonim këngën *Giovinezza, Giovinezza*, që ishte himni fashist i Duçes…

Nxënës dhe mësues të shkollës së Tropojës, vitit 1935

Sa e rregullt ka qenë ajo shkollë e dëshmon kjo fotografi e vitit 1935, ku kanë dalë të gjithë mësuesit dhe nxënësit e saj. Në të gjendet edhe babai im, i cili më vonë u bë mësues dhe shërbeu në disa zona shumë të thella të Malësisë së Gjakovës, si në Theth, Curraj të Epërm, Myhejan dhe Berishë.
Me kalimin e viteve, im atë ma kishte përmendur se ai ministri i famshëm, Mirash, i kohës së Mbretit Zog, ishte dënuar dhe kishte vdekur në burg.

Zbulimi i një trashëgimie të harruar: Ivanaj

Kaq dijeni kam pasur për Ivanajt deri në vitin 1991. Sado e pakëndshme që të duket kjo mungesë njohjeje për figura të tilla të kombit, prapëseprapë ajo ka një justifikim: ne nuk dinim asgjë. Po! Ne dinim për Mandelën e Afrikës, por nuk dinim se në Shqipëri kishte mijëra Mandela – nga Mirash Ivanaj e deri te Pjetër Arbnori – që dergjeshin, vuanin dhe vdisnin në burgje, larg syve të opinionit publik shqiptar dhe të atij ndërkombëtar.

Mirash Ivanaj (1891-1953)

Me rënien e komunizmit, filluan të dalin në dritë emrat e figurave të shquara të kombit tonë, të cilët diktatura jo vetëm që i kishte eliminuar fizikisht dhe u kishte zhdukur varret, por nuk lejonte as që t'u përmendeshin emrat. Ndër ta ishin edhe vëllezërit Martin dhe Mirash Ivanaj.

Kush ishin vëllezërit Martin dhe Mirash Ivanaj?



Martin dhe Mirash Ivanaj *ishin dy figura të shquara të kombit shqiptar – intelektualë, patriotë dhe reformatorë që lanë gjurmë të pashlyeshme në arsim, drejtësi dhe jetën publike shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX.*

- ***Mirash Ivanaj*** *(1891–1953) ishte ministër i Arsimit në periudhën e Monarkisë së Zogut dhe hartuesi i* ***reformës më të rëndësishme arsimore*** *të asaj kohe, e cila përfshinte unifikimin e shkollave publike dhe ndalimin e ndikimit të huaj në edukimin kombëtar. Ai ishte gjithashtu jurist, studiues dhe mbrojtës i flaktë i gjuhës shqipe. U arrestua dhe vdiq në burg gjatë diktaturës komuniste.*
- ***Martin Ivanaj****, vëllai i tij, ishte gjithashtu një intelektual dhe funksionar i lartë shtetëror, i përkushtuar ndaj përparimit të arsimit dhe administratës shqiptare. Ai kontribuoi në ndërtimin e institucioneve shtetërore gjatë periudhës së Pavarësisë dhe më pas.*

Të dy vëllezërit i përkisnin një familjeje me origjinë nga Podgorica dhe lanë pas një ***trashëgimi të pasur patriotike, intelektuale dhe arsimore****, e cila u ringjall me krijimin e* ***Fondacionit "Martin & Mirash Ivanaj"*** *në Tiranë dhe New York nga bijtë e familjes së tyre.*

Në fillim të viteve '90, nëpër gazetat e kohës nisën të përmendeshin emrat e dy vëllezërve Martin dhe Mirash Ivanaj.

Mësuam se ata kishin lindur në Podgoricë, në një familje me origjinë nga Trieshi i Malësisë së Madhe. Fillimisht kishin mësuar aty, e më pas kishin vazhduar shkollimin në Pozharevac të Serbisë, natyrisht në gjuhën serbe. Në atë gjuhë, të dy shkruan me bashkautorësi dy vëllime poetike: *Kulla e Shpresës Sime* dhe *Epopeja e Njeriut*.

Më pas, me shumë përpjekje, arritën të përfundonin studimet në Universitetin e Romës – sot "La Sapienza" – ku secili prej tyre mori dy diploma të shkëlqyera dhe titujt "Doktor i Filozofisë" dhe "Doktor i Jurisprudencës".

Ishte koha kur Shqipëria ishte shpallur e pavarur dhe shtetit i duheshin njerëz të ditur.



Prandaj u kthyen në Shqipëri dhe, së bashku me kushëririn e tyre, Nikollë Ivanaj, themeluan gazetën *Republika*. Më pas shërbyen në administratën e shtetit shqiptar, pa u përfshirë në veprimtari politike.

Në vitet ’30, Martini, si një jurist i talentuar, arriti të bëhej Kryetar i Gjykatës së Kasacionit dhe formuloi e komentoi Kodin e parë të Procedurës Civile në Shqipëri. Ndërsa Mirashi, nga mësues, u bë drejtor i Gjimnazit të Shkodrës dhe më pas Ministër i Arsimit në vitet 1933–1935.

Vëllezërit Martin dhe Mirash Ivanaj

Ai i hapi rrugën laicizmit në arsim dhe e ngriti shkollën shqipe në nivelin e një shkolle kombëtare, me edukim patriotik e shkencor, larg ndikimeve të huaja imperialiste dhe atyre fetare. Më pas, ai shërbeu si Kryetar i Këshillit të Shtetit, prej nga vëzhgonte të gjitha projektligjet, propozimet, miratimet në parlament dhe zbatimin e tyre.

Të dy vëllezërit njihen si reformatorë të mëdhenj dhe njerëz pa kompromis, sidomos kur ishte fjala për të drejtën dhe arsimin shqiptar.

Martini u martua me profesoreshën italiane Giuseppina Pogliotti dhe së bashku patën një vajzë, Dritën. Ndërsa Mirashi nuk u martua kurrë.

Më 7 prill 1939, me pushtimin fashist të Shqipërisë, të dy u larguan nga vendi. Martini nuk jetoi gjatë: vetëm një vit pas largimit ndërroi jetë në Stamboll.

Ndërsa Mirashi, pas shumë peripecish në mërgim, duke besuar se Shqipëria ishte çliruar, u kthye për t'i shërbyer atdheut të tij, ku kishte shtëpinë dhe një bibliotekë me mijëra libra. Por ndodhi ndryshe: shtëpia ishte konfiskuar nga regjimi, biblioteka ishte vjedhur tërësisht dhe, vetë ai, pas një viti, përfundoi në burg, ku vdiq në vitin 1953.

Pas disa dekadash heshtjeje varri rreth këtyre dy vëllezërve patriotë, emri dhe vepra e tyre iu rikthyen kujtesës së shqiptarëve në fillim të viteve '90. U rikthye kujtimi dhe nderimi për Ivanajt – për ata dy që duken si vëllezër "siamezë" në përkushtim, për të përtërirë imazhin e dy shqiptarëve të vërtetë. Ata luftuan në dy fronte thelbësore për shtetin shqiptar: Martini në fushën e drejtësisë, Mirashi në atë të arsimit kombëtar.

"Njohja me Fondacionin Martin & Mirash Ivanaj dhe bijën e tyre DRITA"

Ndonëse isha me shërbim jashtë shtetit, në vitin 1993 mësova se një bijë e familjes Ivanaj kishte ardhur në atdhe. Ajo kishte puthur tokën shqiptare sapo kishte zbritur në të. **Drita Ivanaj** ishte pritur me nderime të mëdha nga autoritetet e qeverisë demokratike të asaj kohe – një qeveri që dallohej për përpjekjet për të rikthyer

dinjitetin dhe nderin e patriotëve që ishin persekutuar nga regjimi komunist.

Pasi u ktheva nga shërbimi im diplomatik shumëvjeçar jashtë shtetit, në vitin 2018, pata rastin të marr pjesë në një forum të organizuar mbi liritë e shtypit në Shqipërinë e sotme. Organizatorët më njoftuan se takimi do të zhvillohej në një institucion me emrin **"Martin & Mirash Ivanaj Foundation"**, në zemër të Tiranës.

Dëshira për të marrë pjesë në atë forum më solli një nga surprizat më interesante, më të dhimbshme, më emocionale, por njëkohësisht edhe më mbresëlënëset e jetës sime: gjeta rastin të shihja nga afër diçka që lidhej drejtpërdrejt me rrëfimin e babait tim për Mirashin dhe për shkollën e viteve '30 të shekullit të kaluar. Po atë ditë pata privilegjin dhe nderin e madh të njihesha edhe me **Dritën**, bijën e njërit prej vëllezërve Ivanaj – **Martinit**.

Babë e Bijë në vogli…

Ajo ishte vërtet një **Dritë** – një dritë që reflektonte iluminizëm, dijeni, dashuri njerëzore dhe sakrifica jetësore. Në fakt, ngjante sikur po prekje vetë historinë – jo në formën e një statuje të heshtur, por të një njeriu të gjallë, që ke përpara dhe të flet me thjeshtësi e ëmbëlsi.

Tek e dëgjon Dritën, të vjen të mendosh për jetën: sa e vështirë është ajo, sa shumë mund të humbasë njeriu, dhe sa shumë forcë duhet për të përballuar dhe tejkaluar të gjitha pragjet që jeta të vë përpara!

Pas takimit të parë, i premtuam njëri-tjetrit se do të mbeteshim në kontakt. Shkëmbyem kartvizita. Njohja më e thellë me Fondacionin "Martin & Mirash Ivanaj", me historinë e dy vëllezërve dhe me vetë Dritën, u kthye për mua në një **detyrë morale**, të cilës nuk do t'i rezistoja dot. Fillimisht mendova t'i dhuroja disa nga librat që kam shkruar vetë.

Zgjodha si më të përshtatshme për t'ia dhuruar Fondacionit **biografinë dhe veprën e amerikanit Charles Telford Erickson**, të botuar në tre volume, si dhe librin mbi ambasadorin amerikan në Mbretërinë Shqiptare gjatë viteve 1930–1933, **Herman Bernstein**. Të dy këtyre figurave – të cilëve u kam kushtuar një pjesë të rëndësishme të jetës sime – kishin dhe kanë lidhje të veçanta me familjen Ivanaj.

Si "kompensim", **Drita më dhuroi** një seri librash kushtuar babait të saj të dashur, **Martinit**, dhe xhaxhait të saj, **Mirashit**.

Kështu, i hyra me pasion njohjes së tyre përmes një sërë veprash letrare dhe historike:

– një libër biografik i shkruar nga **Dr. Iljaz Gogaj**,
– një tjetër nga **Lazër Radi**,
– traktati filozofik kombëtar i **Nikollë Ivanajt**, një i afërt i tyre,
– ciklet poetike të dy vëllezërve, të përkthyera nga **Lazër Radi**

dhe **Dr. Pjetër Dreshaj**,
si dhe shkrimet kushtuar atyre nga zonja **Përtefe Leka**.

Sa më shumë studioja, aq më shumë ndihesha emocionalisht i njëjtësuar me vëllezërit Ivanaj.
Në morinë e veprave që kam lexuar gjatë jetës, gjithmonë jam lidhur thellësisht me personazhet – duke ndjerë gëzimin, dhimbjen, dhe të gjitha përjetimet që të shkakton përshkrimi artistik, sidomos kur vepra është thjesht letrare.

Por kur lexoj, studioj apo përgatis vetë një monografi për një personazh me jetë dramatike – si ajo e vëllezërve Ivanaj – lidhja ime emocionale bëhet shumë më e fortë. Sepse njohja me njerëz të vërtetë është shumë më tepër shpirtërore sesa thjesht artistike.
Në këtë drejtim, më mbetet vetëm të vendos në krye të të gjithëve **jetën dhe veprën e vëllezërve Ivanaj**, e menjëherë pas tyre, atë të **Charles Telford Erickson**, i cili i kushtoi jetën Shqipërisë – duke sakrifikuar edhe ai familjen dhe fëmijët për të mirën e një kombi që e bëri atdheun e tij të dytë.

Ivanajt – Përmendore të Kulturës Shqiptare

Të tillë janë tani për mua **Ivanajt**: dy vëllezër që, megjithë padrejtësitë e historisë, mbetën si përmendore të kulturës, arsimit, letërsisë, sundimit të ligjit, shtetformimit të shqiptarëve dhe, më në fund, të sakrificës sublime.

Dy vëllezër që, ndonëse mund të kishin zgjedhur të jetonin në çdo vend perëndimor – ku, me aftësitë e tyre të jashtëzakonshme, formimin e tyre të thellë arsimor e botëkuptimor, profesionalizmin e lartë, njohjen e shumë gjuhëve të huaja dhe talentin në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, do të kishin pasur një jetë të sigurt dhe të suksesshme – ata zgjodhën të ktheheshin në atdhe. Pikërisht në ditët më të vështira të kombit tonë.

Ishte koha kur po sendërtohej shteti, kur po merrte formë shtetësia – një kohë kur njerëz si ata ishin të paktë për nga aftësia dhe edhe më të rrallë për nga ndershmëria dhe përkushtimi.

Vëllezërit Ivanaj në bibliotkën e tyre, në Tiranë

Të lexosh gjithçka që kanë bërë dhe gjithçka që është shkruar për vëllezërit Ivanaj, është si të kalosh nëpër një rreth emocional ku përjeton ecurinë e dy jetëve epike – malësore, krejt shqiptare, të paepura, stoike dhe heroike.
Është kalvari i jetës së dy vëllezërve kolosë, të cilët patën shumë pak ditë të lumtura në jetën e tyre.

Ata ishin dy djem me një fëmijëri të mbushur me privacione, me vështirësi të mëdha për shkollim, me të ardhura të pakta për ngritje akademike, pa pretendime dhe gjithmonë të gatshëm të shërbenin për atdheun – me çfarëdo çmimi.
Ishin njerëz të vendosur për të sakrifikuar, të pathyeshëm në qëndrimet e tyre, të cilat lidhnin fort karakterin, traditën shqiptare, besnikërinë ndaj atdheut, përparimin dhe modernizimin e tij.

Aq sa ishin poetë dhe të butë si qenie njerëzore, aq ishin të rreptë dhe të palëkundur në mbrojtjen e parimeve të shtetit të së drejtës: të barazisë para ligjit për të gjithë qytetarët, të respektit për njeriun e aftë dhe të ndershëm, dhe të ashpër ndaj çdo armiku të Shqipërisë – kushdo që të ishte dhe ngado që të vinte ai.

Edhe pse të lindur dhe të edukuar si të krishterë të mirë, ata ishin ndër të parët që luftuan për ndarjen e fesë nga shkolla dhe nga shteti. Për ta, ruajtja e të drejtave të klerit nuk presupozonte përfshirjen e tij në çështjet e shkollës; prandaj guxuan të mbyllnin shkollat fetare dhe të lejonin funksionimin e tyre vetëm brenda institucioneve përkatëse.

Të njëjtin qëndrim mbajtën edhe ndaj shkollave të huaja, të cilat helmonin ndërgjegjen kombëtare shqiptare, me përjashtim të dy prej tyre – Shkollës Bujqësore Amerikane të Kavajës, ndërtuar nga Ericksoni, dhe Liceut Francez të Korçës, që drejtoheshin nga shqiptarët.

Historia e Ivanajve – Një model i edukimit dhe vetë-edukimit atdhetar

Të mësosh historinë e Ivanajve do të thotë të pasurohesh shpirtërisht, të edukohesh patriotikisht dhe të mbushesh me ndjenja të forta atdhetarie. Gjatë gjithë kohës që kam studiuar jetën e tyre, më është dukur sikur po sodisja një monument gjigand me fytyrë njeriu. Që ta vështrosh mirë atë, duhet të vësh duart mbi vetulla për të ruajtur sytë nga drita e fortë e madhështisë që të shkakton ai monument i pavdekshëm.

Në gjithë këtë tiradë ngjarjesh dhe rrebeshesh të jetës, nëse do ta përfytyroje si një udhëtim të gjatë figurativ, para syve do të shfaqeshin piramida të shumta, të skalitura me vlera dhe shenja fisnike: poezia, gazetaria, ligjshmëria, mësimdhënia, shkrimet e ndjera atdhetare, respekti për zyrën e shtetit, qëndrimet e

ndershme, “intoleranca” ndaj allishverisheve të nëpunësve të kohës, aftësia pedagogjike e Mirashit dhe mjeshtëria në interpretimin e Kodit Civil nga Martini. Por mbi të gjitha, spikat edhe një cilësi që e dallon malësorin...

Naiviteti i besimit lind kur je thellësisht i bindur se nuk ke bërë kurrë asgjë të keqe në jetë. Mirash Ivanaj besonte me gjithë shpirt se kishte vepruar drejt kur i ndërpreu bursën një studenti anonim, të papërgjegjshëm, që nuk paraqitej në provime gjatë studimeve në Francë. Ai nuk e kishte imagjinuar se ky student do të bëhej një ditë diktatori i Shqipërisë dhe se nuk do ta falte kurrë për atë vendim. I kthyer më vonë në atdhe, me ndershmërinë dhe idealizmin e tij të paprekur, Mirashi erdhi për të kontribuar sërish me dijen e vet, pa as më të voglën ndjesi frike. Por e pësoi... siç e pësoi!

Drita Ivanaj bashkë me prindërit Martinin dhe Giuseppinën

TË BASHKËPUNOSH ME FONDACIONIN IVANAJ – NJË NDER DHE DETYRIM MORAL.

Veprimtaria dhe bashkëpunimi me Fondacionin "Martin & Mirash Ivanaj" është një mundësi e vyer për të njohur historinë e Shqipërisë në ato meridiane ku vepruan këta dy kolosë të kombit. Kjo histori sot mund të mësohet jo vetëm përmes librave, biografive dhe studimeve të shkruara për ta, por edhe falë përkushtimit të pasardhëses së tyre, zonjës Drita, në drejtimin e këtij Fondacioni. Kur hyn në këtë institucion, ndjen se ai është ndërtuar me një përkushtim dhe klas që e bëjnë të denjë për të qenë jo vetëm në Tiranë, por edhe në metropole si New Yorku, Londra, Parisi apo Roma.

Për më tepër, aty takon atë Shqiptare të Rëndë që mban mbi supe peshën e një mbiemri të shenjtë – trashëgiminë e babait të saj, profesor Martin Ivanaj, i cili u nda nga jeta kur ajo ishte vetëm pesë vjeçe; të nënës së saj italiane, profesoreshës së nderuar Giuseppina Pogliotti – Ivanaj, që vdiq dhjetë vjet më vonë; dhe të axhës, Mirash Ivanaj. Në Dritën gjen themeluesen vizionare të Fondacionit që risolli në ndërgjegjen kombëtare emrin dhe veprën e tyre, si dhe në jetën e përditshme mishërimin e artit të të bërit të gjërave në mënyrë të përsosur.

Drita Ivanaj (majtas) dhe e ëma Giuseppina Pogliotti – Ivanaj

Të takosh Dritën do të thotë të takosh një njeri që i ka kapërcyer me dinjitet të gjitha vështirësitë e jetës, falë forcës së karakterit të saj. Fondacionit "Ivanaj" vërtet i mungojnë mijëra librat e bibliotekës së babait dhe axhës së Dritës, të cilat iu rrëmbyen nga diktatura – një fond i çmuar që ishte ndër arsyet pse Mirashi, me një naivitet fisnik, siç e pohonte edhe vetë, vendosi të kthehej në atdhe. Por, edhe pse mungon ai thesar i rrallë, Fondacionit nuk i mungon asgjë tjetër për ta ngjitur emrin **IVANAJ** në piedestalin më të lartë të kulturës, arsimit, letërsisë, humanizmit dhe legjislacionit shqiptar – atje ku rrallëkush nga bijtë e këtij populli ka arritur ndonjëherë.

Një ditë, **monumenti i Vëllezërve Ivanaj** do të duhet të zbukurojë një park në Tiranë dhe një institucion i rëndësishëm arsimor të mbajë me krenari emrin e tyre.

Nderim të përjeshtëm!

PJESA E II – TË

CIKËL VEPRIMTARISH TË ORGANIZUARA NË FONDACIONIN "MARTIN & MIRASH IVANAJ", TIRANË

1

NJË NATË E PAHARRUAR NË SALLËN KRYESORE TË FONDACIONIT MARTIN & MIRASH IVANAJ NË TIRANË:

Jeta e Charles Telford Erickson

Përpara një audience të madhe dhe shumë të nderuar, isha i lumtur të referoja mbi jetën e amerikanit Charles Telford Erickson, i cili i kushtoi jetën Shqipërisë. Lidhja e Mirash Ivanajt me Ericksonin e bënte edhe më kuptimplotë këtë takim. Pasardhësja e vetme e asaj familjeje, Drita Ivanaj, bëri prezantimin dhe moderimin e mbrëmjes. Ish-ministra, ish-diplomatë, historianë, gazetarë, artistë, studiues, lexues dhe miq u njohën jo vetëm me jetën e Ericksonit, por edhe me veprimtarinë e Fondacionit Ivanaj. Poema *Skënderbeu*, e recituar nga aktori Bujar Asqeriu, e bëri mbrëmjen edhe më interesante.

Falënderoj Drita Ivanajn dhe stafin e Fondacionit, si edhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë mbrëmje.

+7

2

“552-VJETORI I HEROIT TONË KOMBËTAR, GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU, NË FONDACIONIN MARTIN & MIRASH IVANAJ, NË TIRANË.”

Më 17 janar, në Ditën e 552-vjetorit të ndarjes nga jeta të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, u zhvillua një përkujtim në mjediset e Fondacionit Martin & Mirash Ivanaj, New York – Tiranë.

E përkujtuam me novelën “NALTËSIMI I ISKANDERIT”, shkruar nga dy herë Kryeministri i Britanisë së Madhe, Benjamin Disraeli, së bashku me miq intelektualë, lexues, diplomatë dhe ish-diplomatë, shkrimtarë, poetë, muzikantë, skulptorë, historianë, profesorë dhe studentë, analistë, politikanë e gazetarë – me të cilët na bashkon emri i Heroit tonë.

Faleminderit Drita Ivanaj, Drejtore Ekzekutive dhe themeluese e Fondacionit, për mundësinë që na dhatë të mblidhemi në atë institucion të mrekullueshëm, të cilin unë e quaj një “Xhevahir në zemër të Tiranës”, për episodin e tretë të serisë: “Anglo-Amerikanët për ne shqiptarët”.

Lavdi Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu! Faleminderit të gjithë pjesëmarrësve! Proud to be Albanian!

January 17 – The Day of the 552nd Anniversary of our National Hero, George Kastrioti Skanderbeg, was commemorated yesterday evening at the Martin & Mirash Ivanaj Foundation, New York – Tirana.

We commemorated him with the novel “*The Rise of Iskander*”, written by the two-time Prime Minister of the United Kingdom,

Benjamin Disraeli, in the company of friends, intellectuals, readers, diplomats and former diplomats, writers, poets, musicians, sculptors, historians, professors, students, analysts, and politicians — all united by the name of our national hero.

My heartfelt thanks to Ms. Drita Ivanaj, Executive Director and Founder of the Foundation, for giving us this golden opportunity to gather at the premises of this remarkable institution — which I consider "A Jewel in the Heart of Tirana" — and to present the third episode of our series: *"The Anglo-Americans for Us Albanians."*

Glory to our National Hero, George Kastrioti – Skanderbeg!
Thank you all for your presence and participation!
Proud to be Albanian!

3

“ANGLO–AMERIKANËT PËR NE SHQIPTARËT” “HERMAN BERNSTEIN – MIKU I SHQIPTARËVE – AMBASADOR I SHBA-SË NË MBRETËRINË SHQIPTARE (1930–1933)”.

Salla ishte e mbushur plot e përplot me vullnetarë të Fondacionit, ish-ministra, ish-ambasadorë, ish-diplomatë, studiues, lexues, historianë dhe dashamirës të Fondacionit dhe të historisë së vendit tonë.

I pranishëm në këtë mbrëmje ishte edhe **Ambasadori i Mbretërisë së Spanjës në Republikën e Shqipërisë, z. Vicente Cannelles Montero**, së bashku me zonjën e tij.

Veprimtaria u hap nga Presidentja e Fondacionit, znj. Drita Ivanaj, e cila vijoi me një prezantim në PowerPoint mbi figurën e Ambasadorit Amerikan dhe kontributin e tij në shërbim të shtetit shqiptar.

Falënderime të veçanta shkojnë për pedagogët e Akademisë së Arteve, profesorët Roland Xhoxhi dhe Milto Kutali, për ndihmën e dhënë në ilustrimin artistik të mbrëmjes.

Ata sollën në skenë studentët e Akademisë së Arteve: Anxhela Gaxhazi, Eleonora Bezati, Arlin Capi dhe Elioz Shuli, me interpretime dinjitoze të poezive të Bernstein-it: *Fluturimi i Kohës*, *Shiu dhe Shkëlqimi Diellor*, *Dashuria e Famës*, si dhe një balladë-homazh për tërmetin që sapo kishte goditur Shqipërinë. Falënderime për znj. Teuta Dhima, bibliografe në Bibliotekën e Durrësit, e cila interpretoi me mjeshtëri poezinë *Muzika* të Bernstein-it, e shoqëruar në violinë nga Prof. Roland Xhoxhi. Po ashtu, falënderime për vogëlushen Amira Ukaj, e cila recitoi poezinë *Legjendë*.

Takimi i radhës do të jetë me temën: *Benjamin Disraeli – Dy herë Kryeministër i Britanisë së Madhe në veprën e tij për Skënderbeun: "Naltësimi i Iskanderit"*, më datë 17 janar 2020.
Krenar që jam shqiptar!

4

“REFLEKSIONE TË NJË HARRESE TË IMPONUAR”

Në mjediset e njërit prej institucioneve më të shkëlqyera dhe dinjitoze të Tiranës, ashtu siç është edhe emri që mban, Fondacioni **Martin & Mirash Ivanaj**, u bë prezantimi i veprës së autores Përtefe Leka në tre volume me titull: **“Refleksione të një Harrese të Imponuar.”**

Në këtë vepër, lexuesi gjen një enciklopedi të vërtetë përshkrimesh të ngjarjeve më të bukura dhe pikante që lidhen me historinë e popullit shqiptar, kontributin e autorëve më të mirë atdhetarë, shkrimtarëve, udhëtarëve dhe politikanëve perëndimorë në dobi të çështjes sonë kombëtare.

Prezantimi i bërë nga Presidentja e Fondacionit, znj. **Drita Ivanaj**, për autoren dhe veprën e saj, si dhe analiza e veprës e paraqitur nga znj. **Ilira Siliqi**, e bënë edhe më të këndshëm takimin me autoren Përtefe Leka.

Nderim për autoren Leka dhe drejtuesen e Fondacionit Ivanaj, znj. Drita Ivanaj.

PERTEFE LEKA
REFLEKSIONE
TË NJË HARRESE TË IMPONUAR
1
PERTEFE LEKA
REFLEKSIONE
TË NJË HARRESE TË IMPONUAR
2
PERTEFE LEKA
REFLEKSIONE
TË NJË HARRESE TË IMPONUAR
3